

# Pabarazitë në Tiranën e madhe

*Analizë e dinamikës së ndryshimeve sociale dhe ekonomike të bashkisë së re*

*Report paraprak*

Arjan Gjonça (LSE)

Pranvera Elezi (INSTAT)

Lantona Sado



- I. Karakteristikat socio-demografike të popullsisë së Tiranës
- II. Përfashtimi social, arsimit, të ardhurat dhe varfëria, dhe shëndeti
- III. Burimet e të ardhurave, punësimi dhe aktiviteti ekonomik në kryeqytet

Raporti ka si qëllim të analizojë me detaje pabarazitë dhe grupet sociale të përjashtuara të popullsisë së Tiranës në të gjitha nivelet, përfshirë dhe bashkitë.

**Burimet e të dhënave:** Census 2001, Census 2011, Anketa të tjera pranë familjeve LSMS 2012, HBS 2014, HBS 2016.

**Rajonet:** Prefektura Tiranë, bashkitë e Prefekturës Tiranë (sipas ndarjes së re administrative territoriale të vitit 2015); në nivel mini-bashkish (sipas ndarjes së vjetër administrative territoriale; pjesa tjetër e Shqipërisë

# I. Karakteristikat socio-demografike të popullsisë së Tiranës

- Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, është një nga qytetet që në Ballkanin jug-perëndimor po rritet më shpejt, madje edhe krahasuar me vende të tjera me të ardhura të ulëta e të mesme.
- Popullsia e këtij qyteti është trefishuar në një periudhë të shkurtër kohore prej 22 vjetësh.
- Në kohën kur u përmbys regjimi komunist në rrethin e Tiranës banonin 280 mijë persona (sipas Censusit të vitit 1989), ndërsa rezultatet e Censusit të vitit 2001 treguan se popullsia e Tiranës u dyfishua dhe arriti në 596.704 banorë (brenda 12 vjetësh), dhe në Censusin e fundit të vitit 2011 popullsia arriti në 763.560 banorë, thuajse tre herë më shumë se në Censusin e vitit 1989.
- Norma vjetore e rritjes së popullsisë për këtë periudhë ishte e padëgjuar më parë - 4,56 %
- Kjo bëhet akoma më e rëndësishme kur krahasohet me normën negative të rritjes së popullsisë së vendit gjatë të njëjtës periudhë me një normë rritjeje vjetore prej - 0,58 % në vit.

- Një nga karakteristikat e rritjes së kryeqytetit të Shqipërisë lidhet me lëvizjet e paplanifikuara të popullsisë që paralelisht u shoqëruan dhe me ndërtimet ligjore dhe joligjore në qytet dhe në rrethinat e tij.
- U krijuan komunitete të tëra në ato zona që më parë ishin toka bujqësore. Por ky fenomen nuk u shoqërua me planifikimet e nevojshme për zhvillimin infrastrukturor.
- Rritja e popullsisë nuk u shoqërua me rritjen e menjëhershme të shërbimeve, si shëndetësore, të arsimit ose të transportit, duke krijuar një situatë fillestare kaotike.
- Kjo rritje kaotike e pashoq, lidhej me rritjen e pabarazive në të gjithë sektorët jetikë, që nda deprivimi në shërbimet shëndetësore e të arsimit deri tek pabarazia në të ardhurat dhe rritja e varfërisë në disa zona.

- Ndërsa popullsia e vendit u zvogëlua si pasojë e migracionit ndërkombëtar i cili vazhdon akoma dhe sot e kësaj dite, popullsia e Tiranës është rritur si pasojë e migracionit të brendshëm.
- Duke qenë kryeqytet i vendit, njerëzit aspirojnë për mundësi më të mira punësimi, shërbime më të mira dhe një standard jetese të përmirësuar.
- Gjatë kësaj periudhe në Tiranë kanë ndryshuar dhe kufijtë administrativë.
- Krahasimi i të dhënave midis Censuseve në këtë raport i referohet 11 mini-bashkive që përbënin Bashkinë e Tiranës deri në reformën territoriale të vitit 2015 ku Tiranës iu shtuan dhe një numër fshatrash rreth saj.
- Ndërsa ka dhe një nivel më të lartë të ndarjes administrative që është prefektura e Tiranës, e cila përfshin gjithashtu bashki të tjera si Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë.


# Norma vjetore e rritjes së popullsisë

	Census 1989	Norma vjetore e rritjes në % (1989- 2001	Census 2001	Norma vjetore e rritjes në % (2001- 2011)	Census 2011
<b>Shqipëria</b>	<b>3,182,417</b>	<b>-0.30</b>	<b>3,069,275</b>	<b>-0.92</b>	<b>2,800,138</b>
Prefektura Tiranë	438,755	2.58	597,899	2.26	749,365
Tiranë	324,532	2.35	430,407	2.59	557,422
Kamëz	10,799	<b>15.02</b>	65,498	<b>4.64</b>	104,190
Vorë	18,128	2.27	23,815	0.69	25,511
Kavajë	52,510	-0.37	50,246	-2.26	40,094
Rrogozhinë	32,786	-1.33	27,933	-2.32	22,148
Pjesa tjetër e Shqipërisë	2,743,662	-0.87	2,471,376	-1.87	2,050,773

- Dy bashkitë në kufi me bashkitë e Tiranës, Vora dhe në veçanti Kamza, kanë pasur rritjen më të madhe gjatë periudhës në studim.
- Bashkia Kamëz është rritur mesatarisht me 15,02 % në vit gjatë periudhës së parë 1989-2001 dhe me 4,6 % në periudhën e dytë 2001-2011.




Shpërndarja e popullsisë së Tiranës sipas mini-bashkive në 2001 dhe 2011




- Ndërkohë që popullsia e Tiranës si e tërë është rritur me shpejtësi, kjo rritje nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë midis mini-bashkive të saj.
- Krahasuar me popullsinë e Tiranës, njësitë bashkiake 3, 4, 5, 6, 8, 10 dhe 11 janë reduktuar në madhësi proporcionalisht.
- Njësitë bashkiake, përsa specifikë e të cilave është rritur dukshëm, janë ato në periferi të njërive bashkiake 2, 7 dhe pjesës tjetër të Tiranës.

Shpërndarja e popullsisë së Tiranës sipas mini-bashkive në 2001 dhe 2011





- Zonat më të populluara vazhdojnë të jenë njësitë bashkiake 2, 5, 7, 11 dhe pjesa tjetër e Tiranës, dhe kjo radhë nuk ka ndryshuar mes dy censuseve.
- Të dhënat tregojnë që një fenomen i mundshëm “largimi nga qyteti” sapo ka filluar në Tiranë, i cili është i ri në rastin e Shqipërisë.
- Njësitë bashkiake 5 dhe 10, të cilat përfaqësojnë qendrën e Tiranës, kanë filluar të ulen në numër në periudhën mes censuseve.

Përqindja e popullsisë së re dhe të moshuar në Tiranë dhe njësitë bashkiake të saj sipas Censurit 2011



- Njësitë bashkiake me popullsinë më të re janë ato që pozicionohen në rrethinat e kryeqytetit dhe bashkitë në periferi (6 dhe 11).
- Popullsia më e vjetër gjendet kryesisht në dy zonat qendrore të Tiranës të cilat janë gjithashtu më të pasurat, njësitë bashkiake 5 dhe 10.
- Popullsia më e re është në njësitë bashkiake 11, dhe popullsia më e vjetër është në qendër të Tiranës (njësia bashkiake 10).

# Tirana krahasuar me pjesën tjetër të vendit



- Në përgjithësi, popullsia e Tiranës është relativisht e re me një numër të madh njerëzish në popullsinë në moshë pune (71,53 %). Krahasuar me pjesën tjetër të Tiranës, dy gjëra duken qartazi:
  - I. Efekti i migracionit në moshat e mesme nuk është shumë i theksuar në kryeqytet siç është në vend, për faktin se Tirana është pikë përqendrimi për migracionin e brendshëm ku të rinjtë e qyteteve të tjera vazhdojnë të migrojnë në Tiranë.
  - I. Tirana ashtu si pjesa tjetër e vendit, vazhdon të ketë më pak fëmijë që hyjnë në bazën e saj të piramidës së popullsisë

# Tirana krahasuar me pjesën tjetër të vendit (2)

---


Në periudhën afatgjatë kjo do të ketë një efekt të dyfishtë.

Së pari, në 20-40 vitet e ardhshme, lindshmëria e ulët do të ndikojë akoma më shumë popullsinë aktive dhe Shqipëria e Tirana do të përballen me problemin e varësisë, dhe nuk do të mund ta përdorin “dividentin demografik”.


Efekti i dytë është që popullsia e Tiranës do të plaket jo vetëm si rezultat i lindshmërisë së reduktuar, por kryesisht si rezultat i migracionit të popullsisë së moshave taksë-paguese.

# Piramidat e popullsisë, Census 2011


Tirana 2011




The Rest of Albania 2011





Kamëz 2011



Vorë 2011



# Tirana krahasuar me bashkitë periferike (Kamëz dhe Vorë)



Dy bashkitë periferike, Kamza dhe Vora, kanë popullsi shumë të re krahasuar me Tiranën dhe pjesën tjetër të vendit.

Popullsia e Kamzës është rritur me dhjetëfish kryesisht si rezultat i migracionit të popullsisë nga rrethet në veri të vendit. Fakti që në këtë bashki nuk ka efekt në moshat e mesme tregon që migracioni i brendshëm është bërë nga e gjithë familja dhe jo vetëm nga anëtarët në moshë të re të familjes.

## **II. Përjashtimi social, arsimit, të ardhurat dhe varfëria, dhe shëndeti**




- Niveli arsimor i popullsisë influencon evoluimin e një shoqërie në shumë aspekte.
- Nxitja e barazisë gjinore në arsimim agresohet si një nga faktorët më të rëndësishëm që shpjegon tranzicionin e lindshmërisë në Shqipëri (Falkingham dhe Gjonça, 2001).
- Niveli arsimor i popullsisë është gjithashtu një tregues i stokut të kapitalit human në dispozicion për të influencuar zhvillimin ekonomik.
- Gjatë 10 viteve të fundit sistemi arsimor në Shqipëri ka ndryshuar.
- Paralelisht me këto ndryshime të rëndësishme në ofertën e arsimit (ofrimi i mundësive), pritet që të jetë ndryshime të rëndësishme dhe në anën e kërkesës (vendimet e familjeve rreth arsimit), duke çuar në modele të reja të shkollimit dhe pjesëmarrjes në të.

- Duke përdorur treguesit standardë, fokusohemi në disa burime të mundshme të pabarazisë në këtë fushë: gjinia, origjina sociale dhe vendodhja hapësinore.
- Metodologjia e përdorur këtu është e thjeshtë: janë përdorur vetëm treguesit standardë të arsimit.
- Treguesit e ndjekjes së arsimit masin rezultatin e procesit të formimit të kapitalit human.
- Treguesit e pjesëmarrjes në arsim (p.sh. raportet e regjistrimit) janë transversale, matje të menjëhershme të pjesëmarrjes aktuale të një grupi në aktivitetet arsimore.


Niveli arsimor i përfunduar i popullsisë mund të shihet në disa këndvështrime. **Shkalla e analfabetizmit** është tregues i parë më i thjeshtë për të matur aftësitë bazë. Ajo mund të konsiderohet si një mënyrë alternative i matjes së pjesës së popullsisë që nuk ka ndjekur shkollën.



**Census 2001: A dini të shkruani dhe lexoni?**




**Census 2011: A dini të shkruani dhe lexoni?**



- Të diturit shkrim e këndim konsiderohet si arritje bazë e arsimit fillor. Sipas përkufizimit të UNESCO-s, analfabetizmi është aftësia që ka dikush të lexojë dhe shkruajë me kuptim një deklaratë të thjeshtë për jetën e përditshme të tij/saj.
- Në vitin 2011, situata lidhur me cilësinë e aftësive elementare të shkollimit të popullsisë që jeton në Tiranë duket që është përkeqësuar në nivel prefekturë dhe po ashtu dhe mes qyteteve. Vihet re një rënie prej 1.1 pikë përqindje.


# Shkalla e analfabetizimit sipas gjinisë, Census 2001

A dini të shkruani dhe lexoni?




# Shkalla e analfabetizimit sipas gjinisë, Census 2011

A dini të shkruani dhe lexoni?




# Niveli arsimor më i lartë i arritur i popullsisë 10 vjeç e lart, 2001 dhe 2011



Gjatë periudhës midis dy censuseve të fundit, popullsia me arsim të lartë është rritur në mënyrë të rëndësishme në të gjithë vendin. Rreth një në 10 individë (14 %) ka të paktën arsim të lartë në 2001 në qytetin e Tiranës dhe kjo përqindje thuhet se është dyfishuar në vitin 2011, në mënyrë homogjene midis bashkive.

### **III. Burimet e të ardhurave, punësimi dhe aktiviteti ekonomik në kryeqytet**

# Raporti mes shkallëve të papunësisë meshkuj-femra



Trendet gjinore në shkallët e papunësisë janë matur si raport i treguesve për meshkujt dhe femrat, ku një raport i lartë tregon për një barazi të madhe gjinore (në favor të femrave).

- Raporti mesatar në nivel vendi i shkallëve të papunësisë meshkuj-femra ishte 0,89 në vitin 2011 krahasuar me 0,66 që ishte në vitin 2001 (respektivisht sipas të dhënave të dy censuseve të fundit)
- Në të gjitha bashkitë e prefekturës së Tiranës, raporti i shkallëve të papunësisë meshkuj-femra është poshtë njëshit në të dy censuset, përveçse në bashkinë Vorë në vitin 2011.
- Edhe pse rezultatet e censusit të vitit 2011 tregojnë një trend në rritje të raportit mes shkallëve të papunësisë meshkuj-femra në të gjitha bashkitë e prefekturës së Tiranës (përveç asaj të Vorës), pabarazia gjinore në pasjen e një pune mbetet persistent.



Bashkitë brenda prefekturës së Tiranës ndryshojnë në aspekte të ndryshme.

Shkallët e papunësisë janë matur në raport me madhësinë e forcës së punës. Në nivel kombëtar, sipas të dhënave të Censurit 2001, shkalla e papunësisë ishte 22,7 %. Shkalla e papunësisë në bashkinë Kamëz ishte 11,8 pikë përqindje më a lartë se shkalla kombëtare.

Për bashkinë Kamëz, i njëjti trend shfaqet në vitin 2011, ku një në dy individë banorë në bashkinë Kamëz në forcë pune deklaruan se ishin të papunë, duke e thelluar akoma më shumë diferencën me shkallën e papunësisë në nivel vendi prej 29,3 %.

Indeksi Theil i shkallës së papunësisë, dekompozuar sipas komponentëve të pabarazisë brenda dhe midis bashkive të reja.


Dispersioni rajonal i shkallës së papunësisë	2001	2011	Ndryshimi në p.p
<b>Indeksi Theil</b>	<b>-1,7%</b>	<b>3,4%</b>	<b>5,2%</b>
<b>Theil i pabarazisë brenda rajoneve</b>	<b>-3,2%</b>	<b>-2,6%</b>	<b>0,6%</b>
<b>Indeksi Theil i pabarazisë midis rajoneve</b>	<b>1,5%</b>	<b>6,0%</b>	<b>4,6%</b>

*Burimi: Llogaritje të autorëve bazuar në të dhënat e censuseve 2001 dhe 2011*


- Indeksi u rrit nga -1,7% në vitin 2001 në 3,4% në vitin 2011, një rritje prej 5.2 pikë përqindje.
- Dispersioni në rritje i shkallës së papunësisë duket që ka një dimension të qartë rajonal.

# Papunësia dhe Arsimimi

Shkalla e papunësisë ulet me rritjen e nivelit arsimor




# Shkalla e papunësisë & migracioni i brendshëm



- Lëvizjet e brendshme të popullsisë u drejtuan drejt qendrave rajonale në rritje.
- Faktorët shtytës dhe tërheqës të lëvizjeve të brendshme të popullsisë konvergjojnë në mundësitë më të mira për punësim në zonat qendrore.
- Por, në vend të një rezultati më të mirë në vendin pritës, shihet se migrantët e brendshëm kanë më shumë gjasa që të gjejnë veten e tyre si të papunë.


# Shkalla e papunësisë & migracioni i brendshëm



- Bashkitë ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme mes tyre.
- Diferenca midis shkallës maksimale dhe minimale të punësimit midis bashkive të Tiranës është më shumë se 15 pikë përqindje.
- Sipas të dhënave të Censurit 2011, bashkia Kamëz është rajoni me papunësinë më të lartë, ku shkalla e papunësisë është dy herë më e lartë se shkalla e papunësisë në bashkinë e Tiranës.

# Migracioni i brendshëm dhe shkallët e punësimit

Koefiçienti i variacionit i ponderuar, shkallët e punësimit 2011



- Rajonet ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme mes bashkive të Tiranës dhe migrantëve dhe jo-migrantëve të brendshëm

Puna për raportin final është në progres.

Rezultatet e paraqitura në këtë studim janë paraprake dhe mund të ndryshojnë gjatë përfundimit të kërkimit.

.

# Faleminderit për vëmendjen tuaj!

